Vendim nr. 321, datë 12.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 12.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **DIANA KADEMI, SUTË KADEMI**

OBJEKTI: **Saktësimi dhe korrigjimi i pasaktësive të dukshme në vendimin nr. 68, datë 04.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur në datën 11.06.2026 dhe të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 128, datë 19.06.2026.**

BAZA LIGJORE: **Neni 80, pika 1, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)* dhe neni 43 i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese *(Rregullorja e Gjykatës)*.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 02.02.2017 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi kundër Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme *(ZVRPP)*, duke kërkuar detyrimin e saj për t'u vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit të të dy pasurive të paluajtshme (truall dhe banesë), për të cilat ato pretendonin se e kishin fituar

pronësinë me trashëgimi ligjore nga gjyshërit, si dhe për t'i pajisur me kartelat e pronësisë dhe me hartat treguese përkatëse.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2512 (80-2017-2536), datë 06.06.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 1312 (86-2024-1437), datë 15.07.2024, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-968, datë 03.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueseve.

3. Në datën 03.07.2025 kërkueset kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata)*, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të të tria gjykatave të zakonshme, me pretendimin se atyre u ishte cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe e drejta e informimit dhe e drejta e pronës. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në parashtrimet e tyre kërkueset kanë ngritur edhe pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit efektiv në gjykatë.

4. Gjykata, me vendimin nr. 68, datë 04.06.2026 *(vendimi nr. 68/2026)*, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ajo ka vlerësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit efektiv në gjykatë ishte paraqitur pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, ndaj nuk mund të merrej në shqyrtim. Ndërsa pretendimet e tjera i ka analizuar në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke i vlerësuar në përfundim si të pabazuara. Vendimi nr. 68/2026 është shpallur në datën 11.06.2026 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 128, datë 19.06.2026. Kopja e arsyetuar e këtij vendimi është u vënë në dispozicion kërkueseve dhe avokatit të tyre në datën 15.06.2026.

5. Në datën 09.09.2026 kërkueset i janë drejtuar Gjykatës, nëpërmjet shërbimit postar, me kërkesë për saktësimin dhe korrigjimin e vendimit nr. 68/2026.

II

Pretendimet e kërkueseve

6. ***Kërkueset***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se në vendimin nr. 68/2026 Gjykata:

6.1. Nuk ka pasqyruar saktë objektin e padisë, duke e kufizuar atë në kërkimin për pajisjen me dokumentacionin e pronësisë, kartelat dhe hartat treguese, pa përfshirë kërkimin për informacion dhe dokumentacion lidhur me veprimet e kryera nga ZVRPP-ja në regjistrin hipotekar, çka ka sjellë përjashtimin e tyre nga mbrojtja që garanton neni 23 i Kushtetutës.

6.2. Nuk ka pasqyruar të dhëna dhe akte thelbësore për identifikimin e pasurive, trashëgimtarëve dhe personave të tretë, përfshirë titujt e pronësisë së trashëgimlënësve, mbi të cilët mbështetej legjitimimi i tyre procedural.

6.3. Ka paraqitur në mënyrë të mangët kronologjinë e fakteve, duke mos pasqyruar shkresat dhe përgjigjet e ZVRPP-së ndaj aplikimeve të tyre që prej vitit 2008, përfshirë ato të përcjella përmes Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Drejtësisë.

6.4. Ka lënë pa pasqyruar një sërë aktesh të administruara në dosjen gjyqësore, përfshirë vendime gjyqësore, kontrata, vërtetime dhe dokumente hipotekare, të rëndësishme për vlerësimin e pretendimeve të tyre.

6.5. Ka arsyetuar në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre lidhur me mënyrën e fitimit dhe regjistrimit të pronësisë nga personat e tretë, ligjshmërinë e akteve të regjistrimit, si dhe faktin se trashëgimtarët e tyre nuk kanë qenë palë në proceset gjyqësore përkatëse.

6.6. Nuk ka marrë parasysh pretendimet për paligjshmërinë e vërtetimit të pronësisë mbi të cilin ishte bazuar kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese, si dhe ka pasqyruar në mënyrë të pasaktë pretendimet për vlerën provuese të kartelës së pasurisë së kësaj shoqërie.

6.7. Ka vlerësuar si pasaktësi referimin prej tyre si njësues të një vendimi të Gjykatës së Lartë, ndonëse kjo rrethanë nuk cenonte, sipas tyre, forcën e atij vendimi.

6.8. Nuk ka kërkuar përgjigje nga ZVRPP-ja për çështjet e ngritura në ankimin kushtetues individual, pavarësisht se barra e provës i përkiste organit administrativ.

6.9. Ka interpretuar gabimisht kërkimet e tyre si kërkime për njohjen e pronësisë, ndërkohë që ato synonin marrjen e informacionit dhe të dokumentacionit për pasuritë. Po kështu, ka vlerësuar gabimisht se titulli i pronësisë për të dyja pasuritë ishte zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6.10. Ka marrë për bazë dokumente të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që i përkisnin një pasurie tjetër, kufitare me pasuritë e tyre, dhe të ndodhur në një zonë tjetër kadastrale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

7. Çdo individ, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të

ankesave kundër vendimeve gjyqësore që cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta. Rregullat procedurale të gjykimit kushtetues përcaktohen në Ligjin Organik të Gjykatës dhe në Rregulloren e saj. Në këtë drejtim, neni 31 i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht shqyrtimit paraprak, gjatë të cilit vlerësohet nëse kërkesa duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

8. Vendimet e Gjykatës, përfshirë vendimet e moskalimit të çështjes në seancë plenare, si rregull, janë përfundimtare dhe nuk mund të ndryshohen pas marrjes së tyre. Megjithatë, Ligji Organik i Gjykatës parashikon dy mekanizma përjashtimorë, që lidhen me saktësimin dhe plotësimin e vendimeve, si dhe me rihapjen e procesit gjyqësor. Në lidhje me mekanizmin e parë, neni 80, pika 1, i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon mundësinë e saktësimit dhe të plotësimit të vendimeve të Gjykatës, ndërsa neni 43 i Rregullores përcakton se vendimet e Kolegjit, të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose të Gjykatës, pas votimit, nuk mund të ndryshohen, por vetëm të saktësohen, plotësohen ose t'u ndreqen gabimet në shkrim, ose pasaktësitë e dukshme, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e tyre. Ndërsa mekanizmi i dytë, i parashikuar nga neni 71/c, pikat 3 dhe 4, i Ligjit Organik të Gjykatës, lidhet me mundësinë e rihapjes së procesit gjyqësor, kur një gjykatë ndërkombëtare ka konstatuar cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit si rrjedhojë e një vendimi të mëparshëm të Gjykatës. Në këtë rast, të drejtën për të kërkuar rihapjen e procesit e ka subjekti në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare.

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkueset i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe korrigjimin e pasaktësive të dukshme në vendimin nr. 68/2026. Me këtë vendim, Gjykata ka rrëzuar ankimin kushtetues individual të kërkueseve, me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve, datë 06.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 15.07.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe datë 03.03.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

10. Kolegji thekson se neni 80 i Ligjit Organik të Gjykatës përcakton afatin ligjor 2-mujor nga shpallja e vendimit për saktësimin dhe plotësimin e tij, afat ky që rikonfirmohet edhe nga neni 43 i Rregullores së saj. Në lidhje me momentin, në të cilin fillon llogaritja e afatit, ai i shpalljes së vendimit, neni 72, pika 4, i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon njoftimin e pjesëmarrësve në proces, ndërsa neni 42, pika 3, i Rregullores përcakton se, ditën e shpalljes, vendimi u njoftohet palëve me shkresë ose me postë elektronike nga administrata e Gjykatës. Në rastin konkret, vendimi nr. 68/2026 është shpallur në datën 11.06.2026 dhe u është njoftuar kërkueseve e mbrojtësit të tyre në datën 15.06.2026, ndërsa kërkesa për saktësimin dhe korrigjimin e tij është paraqitur në datën 09.09.2026, pra në tejkalim të afatit ligjor 2-mujor.

11. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkueset nuk kanë respektuar afatin ligjor 2-mujor për paraqitjen e kërkesës për saktësimin dhe korrigjimin e vendimit nr. 68/2026. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kriterin *ratione temporis*, çka përbën shkak të mjaftueshëm për mospranimin e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a, pikat 1 e 2, dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës.